



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 18.9.2018, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Sërgjan Mitroviq, Liburn Aliu dhe Etem Arifi

Munguan: Besa Gaxherri, Salih Zyba dhe Danush Ademi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

Në fillim të mbledhjes kryetari, i përshëndeti dhe i uroi punë të mbarë anëtarëve të komisionit në mbledhjen e parë të sesionit vjeshtor si dhe i uroi mirëseardhje anëtarit të ri, deputetit **Etem Arifi**.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 24.7.2018;
3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2018;
4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018
5. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.7. 2018;**

Kryetari i komisionit konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.7. 2018.

**3. Miratimi i Raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror 2018;**

**Muharrem Nitaj**, kryetar, tha se është një raport i kompletuar dhe se ky komision ka kryer punë voluminoze në drejtimin e ish- kryetarit z. Daut Haradinaj, duke përgëzuar anëtarët e komisionit dhe ish- kryetarin për punën e bërë.

Në vazhdim përmendi disa nga punët e suksesshme, aktivitetet e realizuara gjatë këtij sesioni. Komisioni mbajti 19 mbledhje të rregullta dhe 15 të grupeve të punës, me ç'rast u shqyrtuan 4 projektligje: 2 prej tyre janë miratuar (Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe Ligji për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore), ndërsa në seancë për lexim të dytë janë edhe 2 Projektligje (Projektligji për veprimtarinë hidrometeorologjike dhe Projektligji për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz); janë ndërmarrë dhe përfunduar 2 nisma legjislative (Nisma legjislative për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe Nisma legjislative për hartimin e Projektligjit për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz); u shqyrtuan 3 raporte të agjencive: (Raportin për gjendjen e mjedisit për vitin 2016; Raportin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017 dhe Raportin e Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit për vitin 2017); e shqyrtuan Strategjinë shtetërore për ujëra 2017-2036 dhe Planin e veprimit për biodiversitetin 2016-2020 si dhe u realizua Konkursi për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës.

Në fund, Nitaj falënderoi të gjithë anëtarët e komisionit për punën e bërë, në mënyrë të posaçme administratën e komisionit, për një punë të jashtëzakonshme.

**Ganimete Musliu**, tha se në raport shihet se e kemi përmbushë agjendën me sukses të Komisionit sipas planit të punës, pasi që të gjitha ligjet që kanë arritur i kemi shqyrtuar dhe proceduar, ndërsa mbetet që Qeveria të sjellë ligjet tjera gjatë këtij sesioni. Gjatë këtij sesioni Komisioni pati një angazhim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, në lidhje me çështjen e mishit dhe kemi arritur ta bëjmë sensibilizimin e opinionit, por edhe të Agjencisë, në lidhje me këtë temë, ndërsa u nda e kënaqur me raportin e hartuar, ku tha se besoj se janë përfshi të gjitha aktivitetet e komisionit.

**Salih Salihu**, tha se raporti është përgatitur mirë dhe janë përfshi të gjitha punët dhe aktivitetet e komisionit gjatë këtij sesioni. Ajo çka e ka karakterizuar këtë komision, ka qenë fryma e mirë bashkëpunuese dhe mbështetja e mirë nga stafi i komisionit.

Në vazhdim përmendi se shumë ligje të rëndësishme nga fusha e bujqësisë dhe mjedisit nuk varen nga ne pse nuk kanë ardhur, por varen nga Qeveria, siç janë: Projektligji për Bujqësi dhe zhvillim rural, për mbrojtjen nga zhurma, për gjuetinë, për biocide, për farëra etj, të cilat janë shumë të rëndësishme, pastaj edhe strategjia kombëtare afatgjate e bujqësisë asnjëherë nuk na erdhi në Kuvend për miratim.

Komisioni në fund e miratoi Raportin e punës për sesionin pranveror 2018.

#### **4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2018;**

**Muharrem Nitaj**, kryetar tha se ky është një plan shumë voluminoz dhe kërkohet punë e madhe për realizimin e tij. Gjatë sesionit pranveror, 4 projektligje të planifikuara arritën në Komision, të cilat komisioni i ka përfunduar, prandaj projektligjet e mbetura do të barten në planin për sesionin vjeshtor. Në sesionin vjeshtor, Komisioni planifikon të shqyrtojë 17 projektligje, prej tyre 9 projektligje nga fusha e mjedisit dhe 8 nga fusha e bujqësisë. Gjithashtu, do të shqyrtohen edhe raporte, siç është ai i mjedisit dhe aktivitete të tjera.

**Ganimete Musliu**, tha se të gjitha projektligjet që kanë ardhur në komision i kemi shqyrtuar, ndërsa propozoi të bëhet një listë me këto projektligje dhe të kërkojmë nga qeveria të vijnë në afat të duhur, mirëpo ajo shtoi se në planin për sesionin vjeshtor, duhet të merremi më shumë me mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjeve, sepse kemi ligje të mira por në zbatueshmëri ka ngecje.

Në lidhje me gjendjen e konservimit të kullave në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, e cila është debatuar disa herë në këtë komision, tha se gjendja e tyre nuk është përmirësuar dhe nuk kemi akoma asnjë intervenim, prandaj në plan të punës propozoi që të planifikohet një vizitë e Komisionit në Kompleksin Memorial në Prekaz dhe të ftohet drejtori i ri

i Agjencisë së Komplekseve Memorialë në Komision t'na informojë për planin dhe kërkesat e tyre për këtë kompleks.

**Salih Salihu**, në lidhje me propozimet për planin e punës, tha se është me interes të realizohet një vizitë në Shqipëri, për tu njohur më mirë në lidhje me disa tema nga fusha e bujqësisë: për dëmet nga breshëri ne s'kemi sistem të mbrojtjes, me e pa se si e kanë rregulluar ata, si e kanë sigurimin e produkteve bujqësore, ligjin për cilësinë e bukës, etj.

**Muharrem Nitaj**, kryetar propozoi që plani i punës me propozimet dhe idetë konkrete nga ana e anëtareve të Komisionit të shqyrtohet dhe të miratohet në mbledhjen e radhës, propozim ky me të cilin u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të Komisionit.

## **5. Të ndryshme.**

Me këtë rast u diskutua orari i mbajtjes së mbledhjeve të komisionit, për shkak se disa deputetë janë anëtarë në disa komisione dhe me qëllim të koordinimit më të mirë. Parimisht u pajtuan që mbledhjet e komisionit të mbahen ditën e martë, në orën 13:00.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45

E përgatiti: **Stafi mbështetës i Komisionit**

Kryetari i Komisionit,  
**Muharrem Nitaj**